



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Faik Konica****SHQIPËRIA - KOPSHTI SHKËMBOR I EVROPËS
JUGLINDORE**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë

Pyetja 7 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Disa nga argumentet që sjell Konica në mbështetje të ndjenjës së fortë kombëtare te shqiptarët janë:

- mendimi i Hobhauzit, të cilit i kishte bërë përshtypje ndjenja kombëtare, si një tipar i shqiptarëve. Për të shqiptarët kanë një shpirt pavarësie dhe dashuri për atdheun që tejkalojnë edhe dallimet fetare.
- konstatimet dhe dëshmitë e Hobhauzit se, nëse ndonjë prej shqiptarëve largohet nga vendi dhe duke rrugëtuar merr vesh se një bashkatdhetar banon në një fshat pranë të cilit mund të kalojë, edhe pse mund të mos e ketë njohur, ai ndërron rrugë dhe shkon për ta takuar.
- admirali Zhyrjen dë Gravjerë, në studimin për shqiptarët, ka vënë në dukje se “kombësia i bashkon shqiptarët shumë më tepër se feja”.
- vëzhgimet e Hobhauzit për frymën kombëtare, sepse ndërmjet viteve 1878 dhe 1920 serbët dhe grekët, këta “humoristë të pavetëdijshëm”, vazhdimisht janë përpjekur që, kundër formimit të një shteti shqiptar të shfrytëzojnë argumentin se nuk ekziston kombi shqiptar.

2 pikë Nëse zbulon dy argumente që sjell Konica.

OSE

1 pikë Nëse zbulon vetëm një argument.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Bashkëkohësit e tij, në trajtimin e çështjes kombëtare, synonin ta lartësonin këtë ndjenjë, duke himnizuar madje, në funksion të atdhetarizmit dhe nevojës për bashkim kombëtar.
- Konica është autori që, për së pari, u përpoq të ishte sa më i saktë në paraqitjen e së vërtetës për shqiptarët dhe për këtë në trajtimin e çështjes u referohet konstatimeve të të huajve (duke qenë kështu objektiv).
- Ai e mbështet argumentin e tij, në perceptime të të tjerëve për këtë ndjenjë dhe kështu siguron besueshmërinë e shkrimit. Në këtë rast ai kapërcen bashkëkohësit e tij.

2 pikë Nëse shpjegon ndryshimin midis Konicës dhe bashkëkohësve të tij në trajtimin e kësaj ndjenje. Në njërin anë në përgjigje theksohet se si e trajtonin bashkëkohësit e Konicës këtë ndjenjë (**1 pikë**) dhe në anën tjetër theksohet si e trajton vetë Konica këtë çështje (**1 pikë**).

OSE

1 pikë Nëse shpjegon vetëm si e trajton Konica këtë çështje, por pa treguar se ç’ mendonin vetë bashkëkohësit e tij (pra jepet një krahasim i pjesshëm).

Pyetja 9 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Thelbi i kësaj polemike është paraqitja më vërtetësi e gjithçkaje që lidhet me shqiptarët e natyrën e tyre, si dhe në trajtimin e karakterit shqiptar kundër atyre që zbulojnë tek shqiptarët natyrën e egër e hakmarrëse, duke nxjerrë në pah, në këtë rast, mungesën e vesit të tradhtisë tek ata.
- Konica polemizon me mendimin grek dhe serb për ekzistencën e kombit tonë.

1 pikë Nëse shpjegon thelbin e polemikës.

DHE

1 pikë Nëse tregon kundër kujt drejtohet kjo polemikë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- *Të palodhur, kureshtarë, atdhetarë, të pamëshirshëm, pasionantë, luftëtarë, ta paduruar, të gatshëm, etj.*

3 pikë Nëse gjen tri karakteristika të shqiptarëve, që janë theksuar nga Konica.

OSE

2 pikë Nëse gjen vetëm dy karakteristika të shqiptarëve.

1 pikë Nëse gjen vetëm një karakteristikë të shqiptarëve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Vepra është shkruar në vetën III.
- **Arsyeja:** autori përpiket të sigurojë një distancë objektive me subjektin e veprës. Qëllimi është për ta bërë atë më të besueshme në sytë e lexuesit.

1 pikë Nëse tregon se në cilën vetë është shkruar vepra.

DHE

1 pikë Nëse tregon arsyen e këtij përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **4 pikë****Model përgjigjeje**

Shkrimi fiton trajtë eseistike për disa nga arsyet e mëposhtme:

- problematika që shtron: të dhëna për historinë, gjeografinë, gjuhësinë e letërsinë, psikologjinë, tiparet e portretit dhe të karakterit si dhe mënyra e jetesës së shpitarëve;
- trajtimi shkencor i problemeve;
- prania e strukturës së esesë;
- pushteti i argumentit (në shumë raste argumenti është i tipit krahasues);
- mbështetja në perceptimet e të huajve;
- fraza e gjatë dhe sqaruese;
- mungesa e figuracionit të ngjeshur;
- fryma kritike.

3 pikë Nëse identifikon tri arsye që e bëjnë shkrimin një ese studimore.

DHE

1 pikë Nëse njërën nga arsyet e dhëna e ilustron me një shembull nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II**Eskili****Koeforet**

Pyetja 13	D	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	D	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje**

motivet janë:

- gjakmarrjes,
- krimi sjell krimin

1 pikë Nëse gjen një nga motivet.

1 pikë Nëse e ilustron me vargje nga fragmenti motivin e gjetur.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (a) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Oresti është në një gjendje të rënduar shpirtërore. Ai as gëzohet as hidhërohet dot: nga një anë ka marrë gjakun e babait, por nga ana tjetër ai është një mëmëvrasës.
- Kjo gjendje e dyzuar, mes hidhërimit të thellë dhe gëzimit, jepet përmes antitezave: *gëzohem dhe rënko, triumfin dhe mynxyrën*. Ndërkohë epiteti *përzishëm* thekson natyrën e kësaj fitoreje.

Figura të tjera:

- *inversioni: përzishëm ndrit*
- *oksimori: përzishëm ndrit*

2 pikë Nëse shpjegon gjendjen psikologjike të Orestit përmes dy figurave të stilistikës (bashkë me ilustrimet përkatëse të tyre).

1 pikë Nëse shpjegon gjendjen psikologjike të Orestit përmes një figure të stilistikës (bashkë me ilustrimin përkatës).

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një interpretim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje****Argumentet:**

- Ai e vrau nënën pasi ajo i vrau të atin.
- E urdhëruan hyjnitë (Apoloni), duke i thënë se do vuante përjetë nëse nuk merrte gjakun e babait.

2 pikë Nëse gjen dy argumentet.

DHE

1 pikë Nëse gjen vetëm një argument.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Detaji I: *një kurorë ulliri*: kurora e ullirit është simboli i paqes. Orestit ka nevojë të bëjë paqe me shpirtin. Ai e di se ndjenja e fajit nuk do t'i shlyhet kurrë nga kujtesa.
- Detaji II: *kërthiza*: Tempulli i Apolonit, në besimin e vjetër helen, mendohej si kërthiza e botës. Aty ai do të shkojë të bëjë pastrimin e tij shpirtëror.

2 pikë Nëse tregon ç' nënkuptojnë dy detajet.

OSE

1 pikë Nëse tregon ç' nënkupton vetëm njëri detaj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Në këtë varg Eskili përmbyll një ide të nisur: gjithkush paguan për atë që bën në këtë jetë dhe në atë jetë.

1 pikë Nëse tregon idenë që kërkon të theksojë Eskili.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (a) **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Eriniet janë krijesa të mbinatyrshe, tek të cilat njeriu nuk ka asnjë lloj pushteti. Por ato janë edhe simbole të ndërgjegjes fajtores të Orestit.
- Ato përshkruhen si krijesa të frikshme, gjakatare, të veshura në të zeza.
- Eriniet mund t'i shohë vetëm Orestin, pasi ai ka kryer krimin. Eskili dëshiron që ne të ndiejmë se Eriniet janë më shumë reale për Orestin, sepse përfaqësojnë ndërgjegjen e tij fajtores.

1 pikë Nëse shpjegon se çfarë janë Eriniet.

1 pikë Nëse tregon se si përshkruhen ato.

1 pikë Nëse shpjegon se pse vetëm Orestin mund t'i shohë ato.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (b) **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Orestin e konsideron vrasjen e së ëmës si detyrë.
- Ajo i ka vrarë të atin. Ndërkohë ai urdhërohet edhe nga vetë perënditë. Gjithashtu shikojmë se ai s'gëzon për këtë vrasje. Brenda vetes ka një luftë psikologjike dhe nuk ndihet i lumtur **qete**. Ai brengoset për nënën e vrarë edhe pse e gëzon plotësimin e detyrës. Ndaj nuk mund të themi që Orestin e dëshironte këtë krim. Edhe para se ta kryente ai ka patur plot dilema.

1 pikë Nëse tregon si e konsideronte Orestin vrasjen e nënës.

1 pikë Nëse shpjegon pse ai e konsideron të tillë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton se cili është heroi tragjik i tragjedisë.
- shpjegon pse mendon se është i tillë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.